



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT - PAS PROCESIT TË ANKIMIT

Për : Operatorin ekonomik “REJ” sh.p.k., me NUIS J93711608Q dhe adresë : Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tiranë.

Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e kufizuar”, e klasifikuar në nivelin “I Kufizuar” (prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë).

Numri i referencës së procedurës (nr. datë urdhër prokurimi): Urdhër Prokurimi nr. 2, datë 24.01.2024, i titullarit të autoritetit kontraktor - Ministria e Mbrojtjes.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim objekti, në Korçë” me fond limit 57,589,973 (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme: Nuk ka patur.

Kohëzgjatja e kontratës: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 6 (gjashtë) muajve.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara :

1. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k., me NUIS J93711608Q dhe ofertë në vlerën 52,982,775.16 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k., me NUIS J62028009B dhe ofertë në vlerën 56,242,323.54 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e treqind e njëzet e tre pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K71820009I dhe ofertë në vlerën 55,836,784.30 (pesëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pikë tridhjetë) lekë pa TVSH.

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm :

1. Operatori ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k., me NUIS J62028009B, për shkak se nga kontrolli i ofertës ekonomike/preventivit të punimeve të paraqitur nga ofertuesi, ka rezultuar se ka një mospërputhje midis vlerës së ofertës pa TVSH të deklaruar në Formularin e Ofertës Ekonomike (56,242,323.54 lekë pa TVSH dhe 66,414,508.25 lekë me TVSH) dhe vlerës së ofertës që rezulton e deklaruar në preventivin e punimeve (55,345,423.54 leka pa TVSH dhe 66,414,508.25 lek me TVSH), autoriteti kontraktor bazuar në nenin 44 të L.P.F.M.S dhe në nenin 50 të Rr.P.F.M.S, kërkoi nga ofertuesi pranimin e gabimit dhe korrigjimin e vlerës së ofruar pa TVSH. Ofertuesi nuk ka pranuar korrigjimin e kërkuar dhe bazuar në nenin 44, pika 5, shkronja “b”, të L.P.F.M.S., autoriteti kontraktor refuzoi ofertën e paraqitur nga ofertuesi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “REJ” sh.p.k., me NUIS J93711608Q dhe adresë : Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 52,982,775.16 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë : Rruga e Dibrës (ish shkolla e Bashkuar), Tiranë, me numër kontakti 042 226 601/2/3, 1320, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, të përcaktuar në njoftimin e fituesit, atëherë autoriteti kontraktor do të konfiskoj sigurimin e ofertës dhe do të lidh kontratën me ofertuesin e renditur i dytë në klasifikimin përfundimtar, sipas parashikimeve në nenin 18 paragrafi 3, të RrPFMS.

Njoftimi i Fituesit është publikuar më datë 18.06.2024, në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 31, të APP.

Ankesa : Nuk ka patur.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR